

**L I G J**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E**  
**LIGJIT PËR MARRËDHËNIET E PUNËS**

Neni

Në Ligjin për marrëdhëniet e punës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 62/2005), në nenin 10 fjalët: "në lartësi prej pesë pagash mesatare mujore në Republikën e Maqedonisë" zëvendësohen me fjalët: "në pajtim me Ligjin për marrëdhëniet obligative".

Neni 2

Në nenin 13 paragrafi (3) ndryshon si vijon:

"Punëdhënësi është i detyruar ta lajmërojë, përkatësisht ta çajmërojë punëtorin në sigurimin e detyrueshëm social (pensional dhe invalidor, shëndetësor dhe sigurimin në rast të papunësisë), në pajtim me dispozitat e veçanta, në Agjencinë e Punësimi të Republikës së Maqedonisë, në formë elektronike ose drejtpërsëdrejti në Agjenci, në afat prej tri ditësh nga dita e nënshkrimit të marrëveshjes për punësim."

Pas paragrafit (3) shtohen dy paragrafë të rinj (4) dhe (5) si vijojnë:

"(4) Agjencia për Punësim e Republikës së Maqedonisë, Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë dhe Fondi për Sigurim Shëndetësor i Republikës së Maqedonisë, janë të detyruar të mbajnë dhe në mënyrë të përhershme ta ruajnë evidencën e të lajmëruarve dhe të çajmëruarve në sigurimin social dhe me kërkesën e personit t'i japin të dhëna për gjendjen dhe ndryshimet në lidhje me sigurimin social të punëtorit.

(5) Agjencia për Punësim e Republikës së Maqedonisë, Fondi për Sigurim Pensional dhe Invalidor i Maqedonisë dhe Fondi për Sigurim Shëndetësor i Republikës së Maqedonisë, bëjnë shkëmbimin e të dhënave në lidhje me sigurimin social."

Paragrafët (4), (5), (6) dhe (7) bëhen paragrafë (6), (7), (8) dhe (9).

Neni 3

Në nenin 22 paragrafi (1) pika 4 shlyhet, ndërsa pika 5 bëhet pikë 4.

Neni 4

Neni 46 ndryshon si vijon:

"(1) Marrëveshje për punësim mund të lidhet në kohë të caktuar për kryerjen e punëve të njëjta, me ndërprerje ose pa ndërprerje deri në pesë vjet.

(2) Marrëveshja për punësim në kohë të caktuar për zëvendësimin e punëtorit që mungon përkohësisht, mundet të lidhet deri në kthimin e punëtorit që mungon përkohësisht.

(3) Marrëdhënia e punës e themeluar me marrëveshje për punësim në kohë të caktuar, përveç marrëveshjes për punësim për kryerjen e punës sezonale, transformohet në marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar, nëse punëtori vazhdon të punojë pas skadimit të afatit nga paragrafi (1) i këtij neni, nën kushte dhe në mënyrë të përcaktuar me ligj."

Neni 5

Në nenin 76 paragrafi (2) shlyhet.

Neni 6

Neni 98 fshihet.

Neni 7

Në nenin 102 paragrafin (2) fjalët: "në lartësi prej 70% nga fitimi i humbur" fshihen.

Në paragrafin (5) fjalët: "në shumë prej së paku tri, e më së shumti 12 rroga mesatare të punëtorit të paguara në 12 muajt e fundit" shlyhen.

Në paragrafin (7) fjala "punë" zëvendësohet me fjalët "punësim".

Neni 8

Neni 104 ndryshon si vijon:

"(1) Punëdhënësi ia ndërpret marrëveshjen për punësim punëtorit kur punëtori do të mbushë moshën 64 vjeçe dhe 15 vjet stazh pensional.

(2) Punëdhënësi, me kërkesën e punëtorit nga paragrafi (1) mund t'ia vazhdojë marrëveshjen për punësim më së shumti deri në moshën 65 vjeçe, nëse me ligj nuk është rregulluar ndryshe."

Neni 9

Në nenin 106 paragrafi (3) fjala "E diel" zëvendësohet me fjalët: "punë në ditën e pushimit javor".

Neni 10

Në paragrafin 117 paragrafi (2) pas fjalës "turne", vendoset pikë dhe fjalët deri në fundin e fjalisë shlyhen.

Neni 11

Në nenin 128 në paragrafin (4) fjalia e dytë shlyhet.

Neni 12

Në nenin 134 paragrafi (2) ndryshon si vijon:

"Ditë e pushimit javor sipas rregullit është dita e diel ose ditë tjetër gjatë javës".

Paragrafi 3 fshihet.

Neni 13

Neni 137 paragrafi (1) ndryshon si vijon:

"Punëtori ka të drejtë për pushim të paguar vjetor së paku 20 ditë."

Pas paragrafit (1) shtohet paragrafi i ri (2), si vijon:

"(2) Pushimi vjetor nga paragrafi 1 i këtij neni me marrëveshje kolektive ose me marrëveshje për punësim mund të vazhdohet deri në 26 ditë pune."

Në paragrafin (2) që bëhet paragraf (3) dhe pas fjalëve: "punëtor më i moshuar" shtohen fjalët: "nga neni 179 i këtij ligji".

Paragrafi (3) bëhet paragraf (4).

Neni 14

Në nenin 139 pas fjalës së parë "punëtori" shtohen fjalët: "i cili për herë të parë themelon marrëdhënie pune".

Neni 15

Në nenin 140 paragrafi (1) fjalët: "1/12 e pushimit vjetor nga" zëvendësohet me "dy ditë për", ndërsa pika 3) shlyhet.

Paragrafi (2) shlyhet.

Neni 16

Në nenin 141 paragrafi (4) fjalët: "nëse në vitin kalendarik, në të cilin i është caktuar pushimi, ka punuar së paku gjashtë muaj", shlyhen.

Neni 17

Në nenin 145 paragrafi (1) ndryshon si vijon:

"Nëse punëdhënësi nuk ia ka mundësuar shfrytëzimin e pushimit vjetor, punëtori ka të drejtë për dëmshpërblim për ditët e pashfrytëzuara të pushimit vjetor, në lartësi të rrogës mesatare të punëtorit për ato ditë."

Neni 18

Në titullin e kreut XIV pas fjalës "invalidë" shtohen fjalët: "me të drejtë të rehabilitimit profesional".

Neni 19

Neni 178 ndryshon si vijon:

"(1) Punëtorit invalid të punës me të drejtë të rehabilitimit profesional në bazë të paaftësisë profesionale për punë, punëdhënësi është i detyruar t'i ofrojë kushte për kryerjen e rehabilitimit profesional dhe ta sistemojë në punë tjetër me orar të plotë pune në pajtim me dispozitat e sigurimit pensional dhe invalidor.

(2) Punëtorit te i cili ekziston rrezik i drejtpërdrejtë nga paraqitja e invaliditetit, punëdhënësi është i detyruar t'i sigurojë sistemin në punë tjetër përkatëse dhe kompensim të rrogës në lartësi e dallimin ndërmjet rrogës në të cilën ka punuar punëtori para sistemimit dhe rrogës në vendin e ri të punës.

(3) Rrezik nga paraqitja e invaliditetit në kuptimin e paragrafit 2 të këtij neni ekziston kur punëtori për shkak të kryerjes së detyrave të caktuara të punës, kushtet për punë pa marrë parasysh masat që aplikohen ose mund të aplikohen, ndikojnë në gjendjen shëndetësore dhe aftësinë e punës së punëtorit në atë masë që është vërejtur çrregullim i gjendjes së tij shëndetësore, për çka nevojitet sistemimi në vend tjetër të punës që përkon me arsimin dhe aftësinë e tij për shkak të pengimit të paraqitjes së invaliditetit.

(4) Ekzistimin e rrezikut nga paraqitja e invaliditetit me ekspertizë, vlerësim dhe mendim e përcakton Komisioni për vlerësimin e aftësisë për punë në Fondin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë."

#### Neni 20

Në nenin 181 paragrafi (4) fjala "ankesë" zëvendësohet me fjalën "padi".

#### Neni 21

Në nenin 182 paragrafi (1) fjalët: "këshilli i pajtimit i përbërë nga tre anëtarë prej të cilëve njërin caktojnë punëdhënësi dhe punëtori" zëvendësohen me fjalët: "organ i përcaktuar me ligj".

Paragrafi (2) fshihet.

#### Neni 22

Titulli para nenit 183 ndryshohet si vijon: "Zgjidhje të qetë të kontesteve kolektive me arbitrim".

#### Neni 23

Në nenin 236 paragrafi (3) fjalët: "dhe akti i ministrit kompetent për punët nga sfera e punës" shlyhen.

Në paragrafin (5) presja dhe fjala "kohëzgjatja" shlyhen.

#### Neni 24

Titulli nga Kreu 24 - librezë pune, nëntitujt dhe nenet 253, 254 dhe 255 shlyhen.

#### Neni 25

Pas nenit 263 në titullin e XXVI. DISPOZITA NDËSHKUESE fjala "NDËSHKIMORE" zëvendësohet me fjalën "PËR KUNDËRVAJTJE".

#### Neni 26

Neni 264 ndryshon si vijon:

"(1) Gjobjë në shumë prej 8.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kryerjen e kundërvajtjes punëdhënësit - person juridik, nëse:

1) kërkuesin e punësimit ose punëtorin e vë në gjendje të palakmueshme (neni 6);

2) nuk është lidhur marrëveshje për punësim ndërmjet punëtorit dhe punëdhënësit, punëdhënësi nuk e ka paraqitur punëtorin në sigurim të detyrueshëm pensional dhe invalidor, sigurim shëndetësor dhe sigurim në raste të papunësisë para fillimit të punëtorit me punë, marrëveshja për punësim nuk është lidhur në formë të shkruar, nuk ruhet në lokalet e punës së punëdhënësit ku punon punëtori dhe punëtorit nuk i është dorëzuar ekzemplar nga marrëveshja për punësim (nenet 13 dhe 15);

3) lidh marrëveshje për punësim me person i cili nuk i ka mbushur 15 vjet dhe i cili nuk ka aftësi të përgjithshme shëndetësore dhe nuk i plotëson kushtet e përcaktuara dhe të kontraktuara për kryerjen e punës, të përcaktuara me ligj, marrëveshjen kolektive, aktin e punëdhënësit, përkatësisht të kërkua nga punëdhënësi (nenet 18 dhe 19);

4) lidh marrëveshje për punësim me shtetas të huaj i cili nuk i plotëson kushtet e përcaktuara me këtë ligj apo ligj tjetër (neni 20);

5) shpall vend të lirë pune në kundërshtim me nenet 23 dhe 24 të këtij ligji;

6) punëdhënësi nuk i respekton të drejtat dhe detyrimet nga nenet 25 dhe 27 të këtij ligji;

7) nuk siguron kushte për siguri të jetës dhe shëndetit të punëtorëve në pajtim me dispozitat për mbrojtje gjatë punës (neni 42);

8) nuk e mbron dhe respekton personalitetin, dinjitetin, privatësinë e punëtorit dhe nuk kujdeset për mbrojtjen e të dhënave personale të punëtorit (nenet 43 dhe 44);

9) punëtori i cili punon me orar të shkurtuar pune i urdhëron të punojë jashtë orarit me marrëveshje dhe nëse inspektorit të punës nuk i paraqet ekzemplar të marrëveshjes për kryerjen e punës në shtëpi (nenet 48, 50 dhe 60);

10) shkëputja e marrëveshjes për punësim është bërë në kundërshtim me këtë ligj (nenet prej 72 deri në 105, përveç dispozitës nga neni 100);

11) nuk ka paguar rrogë, përkatësisht rrogë më të ulët dhe nuk i ka paguar kontributet e rrogës (nenet prej 105 deri në 114);

12) punëtorit i urdhëron të punojë me orar më të gjatë pune se orari i punës së përcaktuar me ligj, nuk mban ose në mënyrë të parregullt mban evidencë për orarin e punës dhe për punën jashtë orarit të punës (nenet 116, 117, 119 dhe 120);

13) nuk i respekton dispozitat për sistemimit dhe ndërrimit të orarit të punës (nenet 124 dhe 125);

14) punën e natës e organizon në kundërshtim të neneve prej 127 deri në 131 të këtij ligji;

15) punëtorit nuk i siguron pauzë gjatë orarit të punës, pushim ndërmjet dy ditësh pune njëra pas tjetrës, pushim javor dhe vjetor në pajtim me këtë ligj dhe nuk lëshon aktvendim për pushim vjetor (nenet prej 132 deri në 156);

16) punëtores, prindit, adoptuesit të fëmijës dhe prindit të fëmijës me të meta më të rënda në zhvillim nuk u siguron të drejtë për mbrojtje të veçantë në pajtim me këtë ligj (nenet prej 160 deri në 171);

17) punëtorëve të cilët ende nuk i kanë mbushur 18 vjet nuk u siguron mbrojtje në pajtim me këtë ligj (nenet 172 deri në 176);

18) invalidëve dhe punëtorëve më të moshuar nuk u siguron mbrojtje në pajtim me nenet prej 177 deri në 180 të këtij ligji;

19) punëdhënësi tenton të realizojë ose realizon mbikëqyrje të ndaluar mbi sindikatën ose bashkimin e sindikatës (neni 195);

20) nuk lëshon vërtetim për listën ose lëshon vërtetim me listë me të dhëna të pasakta dhe jo të plota për anëtarët e sindikatës të cilët paguajnë anëtarësi;

21) punëtorin i cili organizon ose ka marrë pjesë në grevë, të organizuar në pajtim me ligjin, e vë në situatë të pavolitshme se punëtorët tjerë (neni 239);

22) kryerjen e punës jashtë vendit e organizon në kundërshtim me këtë ligj (nenet 248 dhe 249);

23) organizon punë fëmijëve, nxënësve dhe studentëve, në kundërshtim me nenin 250 të këtij ligji dhe

24) e pengon ose tenton ta pengojë inspektorin e punës në zbatimin e mbikëqyrjes, nëse nuk vepron sipas aktvendimit të inspektorit të punës për mënjanimin e cenimit të ligjit ose të dispozitës tjetër me urdhëresën e inspektorit të punës për ndalesën e punës ose kryerjen e veprimtarisë (nenet 256 dhe 263).

(2) Gjobjë në shumë prej 5.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtje të kryer nga paragrafi 1 i këtij neni edhe punëdhënësi - person fizik.

(3) Gjobjë në shumë prej 1.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kundërvajtjen nga paragrafi 1 i këtij neni drejtorit, përkatësisht personit tjetër përgjegjës të punëdhënësi."

## Neni 27

Neni 265 ndryshon si vijon:

"(1) Gjобë në shumë prej 1.000 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet në vendngjarje për kundërvajtje të kryer punëdhënësit - person juridik, nëse:

1) kandidatit e pazgjedhur nuk e njofton, në afat prej tetë ditësh pas lidhjes së marrëveshjes për punësim se nuk është zgjedhur ose kandidatit nuk ia kthen dokumentet të cilët i ka dorëzuar si dëshmi për plotësimin e kushteve të kërkuara për kryerjen e punës (neni 27);

2) lidh marrëveshje për punësim në kohë të caktuar në kundërshtim me nenin 46 të këtij ligji;

3) stazhi i praktikantit zgjat më shumë se koha e përcaktuar në nenin 57 të këtij ligji;

4) lidh marrëveshje për punësim në të cilën është бërë marrëveshje për punë provuese në kohëzgjatje më shumë se lejohet me ligj (neni 60);

5) gjatë pushimit të marrëdhënies së punës punëdhënësi nuk vepron në pajtim me nenin 63 të këtij ligji;

6) shkëputja e rregullt ose e çrregullt e marrëveshjes për punësim nuk kumtohet në formë dhe me përmbajtje të shkruar dhe nuk dorëzohet në pajtim me nenet 70 dhe 71 të këtij ligji;

7) atëherë kur është i detyruar refuzon të marrë pjesë në procedurën për zgjidhjen e qetë të kontesteve të punës (nenet 182 dhe 183) dhe

8) lidh marrëveshje në kundërshtim me nenin 252 të këtij ligji.

(2) Gjобë në shumë prej 800 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet në vendngjarje për kundërvajtje të kryer nga paragrafi (1) i këtij neni punëdhënësit - person fizik.

(3) Gjобë në shumë prej 600 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet në vendngjarje për kundërvajtje të kryer nga paragrafi (1) i këtij neni drejtorit, përkatësisht personit tjetër përgjegjës te punëdhënësi."

(4) Ftesë për pagimin e gjobës nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni kryerësit të kundërvajtjes do t'i dorëzojë inspektori i punës në vendngjarjen e kundërvajtjes."

## Neni 28

Në nenin 266 paragrafi (1) fjalja hyrëse ndryshohet si vijon:

"Gjобë në shumë prej 1.200 euro me kundërvlerë në denarë do t'i kumtohet për kryerjen e kundërvajtjes sindikatës, përkatësisht bashkimit të sindikatave dhe punëdhënëseve, nëse:"

## Neni 29

Pas nenit 266 shtohet nen i ri 266-a, si vijon:

## "Neni 266-a

(1) Nëse inspektori i punës vërteton se është kryer kundërvajtje nga nenet 264, 265 dhe 266 të këtij ligji, është i detyruar që kryerësit të kundërvajtjes t'i propozojë procedurë për barazim dhe ndërmjetësim në pajtim me Ligjin për kundërvajtjet.

(2) Për kundërvajtjet nga neni 264, 265 dhe 266 të këtij ligji, procedurë për kundërvajtje mban edhe sanksion për kundërvajtje kumton gjykata kompetente."

## DISPOZITAT KALIMTARE

## Neni 30

Punëdhënësi është i detyruar që në afat prej dy muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji punëtorit t'ia kthejë librezën e punës.

## Neni 31

Afati nga neni 46 llogaritet te marrëveshjet e lidhura pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

## Neni 32

Autorizohet Komisioni juridiko-ligjdhënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë të përcaktojë tekstin e spastruar të Ligjit për marrëdhënit e punës.

## Neni 33

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

## 2090.

Врз основа на член 75 ставови 1, 2 и 3 од Уставот на Република Македонија, претседателот на Република Македонија и претседателот на Собранието на Република Македонија издаваат

**У К А З  
ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ  
ЗА ЛОБИРАЊЕ**

Се прогласува Законот за лобирање, што Собранието на Република Македонија го донесе на седницата одржана на 27 август 2008 година.

Бр. 07-3628/1  
27 август 2008 година  
Скопје

Претседател  
на Република Македонија,  
**Бранко Црвенковски, с.р.**

Претседател  
на Собранието на Република  
Македонија,  
**Трајко Вељаноски, с.р.**

**ЗАКОН  
ЗА ЛОБИРАЊЕ**

**I. ОПШТИ ОДРЕДБИ**

## Член 1

(1) Со овој закон се уредуваат начелата на лобирање, условите за стекнување својство на лобист, регистрирањето на лобистите, водењето на Регистарот на лобисти, правата и должностите на лобистите, активностите кои не се сметаат за лобирање, надзорот над лобирањето и мерките што можат да му се изречат на лобистот заради непочитување на одредбите од овој закон.

(2) Овој закон се однесува на лобирањето кај законодавната и извршната власт на централно ниво, како и кај советот и градоначалникот на локално ниво.

(3) Страните вклучени во лобирањето ќе ги почитуваат начелата и правилата утврдени со овој закон.

## Член 2

(1) Одделни поими употребени во овој закон го имаат следново значење:

- "лобирање" е активност насочена кон законодавната и извршната власт на централно ниво, како и кон локалната власт, заради остварување определени интереси во процесот на донесување закони и други прописи,

- "лобист" е физичко лице кое врши лобирање за соодветен паричен надоместок, регистрирано за вршење на лобирање согласно со овој закон, или е вработено во правно лице кое е регистрирано за вршење на лобирање со кое е склучен договор за лобирање и

- "нарачател на лобирање" е заинтересирано физичко или правно лице кое има интерес од лобирањето пред законодавната, извршната и локалната власт.

**II. НАЧЕЛА НА ЛОБИРАЊЕТО**

## Член 3

(1) Лобирањето се спроведува доброволно, врз основа на писмен договор меѓу лобистот, односно правното лице кај кое е вработен лобистот и нарачателот на лобирањето, како страни во лобирањето.